



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3377/ 10 prot.,

Datë 22.01.2026

V E N D I M

Nr. 116/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.01.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.

Anulimi i procedurës së prokurimit sipërcituar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, me Nipt M38106801F, Adresa: BARAJ, 01960008 Nd.64, H.1, Mallakastër.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Belsh.
Adresa: Belsh Qendër.

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit

Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 15.08.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.

II.2. Në datën 28.10.2025, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), Autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertat sipas renditjes në vijim:

1. Idealdevs Corporation SHPK	me vlerë	2,160,900 L.pa Tvsh	Skualifikuar
2. Evolve Web Studio SHPK	“	2,175,000 “	Skualifikuar
3. DATECH SHPK	“	2,200,000 “	Skualifikuar
4. LACONICS SHPK	“	2,390,000 “	Kualifikuar

II.4. Në datën 18.11.2025 është publikuar njoftimi i fituesit në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, si dhe publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik nr. 75, datë 02.12.2025.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6119, datë 24.11.2025 dhe me Nr. 3377/2025 Prot., date 25.11.2025 e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës, u konstatua se objekti i saj lidhet me shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formularin për publikim nr. 3377/1 prot., datë 26.11.2025 lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues në lidhje kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij.

II.7. Komisioni i Prokurimit Publik me shkresën nr. 3377/2 prot., datë 15.12.2025 i kërkoi autoritetit kontraktor, të dërgojë brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi trajtimin e ankesës dhe vendimmarrjen e autoritetit mbi ankesën e operatorit ekonomikë “Idealdevs Corporation” ShPK për procedurën e mësipërme objekt ankimi.

II.8. Me shkresën me Nr. 4269/1 Prot., datë 17.12.2025, protokolluar me tonën me Nr. 3377/3, datë 22.12.2025 me anë të së cilës informon mbi procedurën e prokurimit nga ku në mënyrë të përmbledhur informon:

*[...]Autoriteti kontraktor deklaron, se në momentine përfundimit të fazës së vlerësimit të ofertave, publikimit të joftimit të fituesit paraprak dhe njoftimi i fituesit përfundimtar pas afateve ta ankimit si dhe lidhjes së kontratës përkatëse **nuk ka qenë në dijeni për ekzistencën e ndonjë ankesë të paraqitur për këtë faze të procedurës.** Si rrjedhojë AK ka vijuar me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit në mirëbesim, në respektim të afateve ligjore dhe pa qenë i informuar në mënyrë efektive për ekzistencën e një ankese duke lidhur kontratën përkatëse e cila aktualisht ndodhet në fazë zbatimi (bashkëlidhur kontrata).*

*Lidhje e kontratës është bërë në respektim të parimit të sigurisë juridike me qëllim garantimin e vijimësisë së shërbimit publik. **Kontrata u nënshkrua më datë 04.12.2025, Nr. 2892/7 prot aktualisht në fazën e zbatimit me afat 20 ditë nga nënshkrimi.***

II.9. Me shkresën me Nr. 3377/4 prot., datë 22.12.2025 drejtuar Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik citon:

[...] Nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se procedura e mësipërme e prokurimit është arkivuar, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës operatorit ekonomik Idealdevs Corporation” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike, të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.10. Me shkresën me Nr. 3377/5 prot., datë 13.01.2026 me objekt rikërkesë drejtuar Autoritetit Kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik citon:

[...]Me shkresën Nr. 3377/4 Prot., datë 22.10.2025, me objekt “Kërkesë”, drejtuar Autoritetit Kontraktor, Komisioni kërkoj që Procedura e prokurimit të kthehet Sistem me qëllimin e shqyrtimit nga KPP të ankesës së operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK.

Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik të prokurimeve rezulton se procedura e mësipërme e prokurimit është e arkivuar, duke bërë të pamundur shqyrtimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

Përsa më sipër, me qëllim gjykimin e ankesës operatorit ekonomik Idealdevs Corporation” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik kërkon kthimin në sistemin operacional të portalit të prokurimeve publike, të Agjencisë së Prokurimit Publik të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.11. Me shkresën përcjellë me e-mail me datë 14.01.2026 AK informon: “AK ka marrë përgjigje nga APP e cila ka konfirmuar rikthimin në sistem të procedurës së prokurimit me nr. REF-58131-08-14-2025 nga arkiva. Në këto kushte duke qenë se procedura është rikthyer në sistem jemi në pritje të vendimit të Komisionit për shqyrtimin e ankesës.”

II.12. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 4377/1 prot, datë 14.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3377/6, datë 19.01.2026, Autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë KPP-së Informacion mbi veprimet e ndërmarra për nxjerrjen e procedurës së prokurimit nga arkiva elektronike.

II.13. Me shkresën ardhur me shërbim postar me nr. 123/1 prot, datë 15.01.2026, protokolluar me tonën me nr. 3377/7, datë 19.01.2026, Autoriteti kontraktor informon KPP-në mbi rikthimin në sistem të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.14 Në përputhje me nenin 113 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, referuar dosjes administrative, konstatohet se nuk janë paraqitur argumente nga subjekte të interesuar në lidhje me ankesën.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të autoritetit kontraktor për skualifikimin e ankimesit nga procedura e prokurimit me arsye:

Arsye e skualifikimit:

Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK me Nipt M38106801F, nuk ka arritur të paraqes dokumentacion të plotë e të saktë ligjor që dëshmon plotësimin e të gjithë kërkesave për kualifikim. Konkretisht nuk ka arritur të paraqes dokumentacionin si me poshtë:

***Ne piken 2.3.4** Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë .Net me të paktën 5 vite ekperience (e provuar me CV, kontrate pune, diplome, të deklaruar në listepagese).*

***Ne piken 2.3.5** Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë React me të paktën 7 vite ekperience dhe i certifikuar me ISO 27001 (e provuar me CV, kontrate pune, të deklaruar në listepagese)*

***Ne piken 2.3.6** Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator me të paktën 5 vite ekperience (e provuar me CV, kontrate pune, të deklaruar në listepagese)*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” është vërejtur se OE nuk ka ngarkuar në sistemin elektronik dokument të plote provues për këto pika. Për përmbushjen e këtyre pikave janë kërkuar që për punonjësit të paraqiten CV, kontrate pune, diplome, të deklaruar në listepagese, por CV nuk janë ngarkuar për asnjë punonjës, gje që e bën të pamundur identifikimin e viteve në pune të punonjësve, gjithashtu në kontratat e punës nuk janë përcaktuar pozicionet e punës si zhvillues senior NET, React dhe Oracle Database sic janë kërkuar në DST.

***Ne piken 2.3.7** Operatori Ekonomik duhet të vertetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert audiues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën përkatëse dhe kontratë)*

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” është vërejtur se OE nuk ka ngarkuar në sistemin elektronik asnjë dokument provues për këte pike.

Bazuar në VKM Nr.285/2021 “Per miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 41 “Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve” pika 4/b citohet: Për të provuar përshatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon...:

b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose si edhe në Nenin 82 të VKM Nr.285/2021 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, në piken 2/iii citohet:

Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme. Një ofertë e përgjegjshme/vlefshme është ajo që plotëson kërkesat e dokumenteve të tenderit pa devijim material, rezervë ose mospranim, siç përcaktohet më poshtëiii. “Mospranimi” është mosparaqitja e një pjese ose e të gjithë informacionit ose dokumenteve të kërkuara në dokumentet e tenderit.

Pra është kërkuar që për kualifikimin e operatorit të paraqitet pikat e sipërpërmendura, ndërkohë që OE nuk e ka përmbushur siç është kërkuar ne DST dhe dispozitat ligjore te prokurimit. Mosparaqitja e tyre përbën kusht për skualifikim.

III.1.1. Autoritetet kontraktor ka publikuar në SPE, Dokumentet e tenderit, shtojcën 9,

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- 2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve të bëra në shtojcën 9 të DST-ve (Kriteret e përgjithshme të Perzgjedhjes/Kualifikimit).

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë. Net me të paktën 5 vite ekperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, diplomë, të deklaruar në listëpagesë).

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë React me të paktën 7 vite ekperiencë dhe i certifikuar me ISO 27001 (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listëpagesë).

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator me të paktën 5 vite ekperiencë (e provuar me CV, kontratë pune, të deklaruar në listëpagesë).

2.3.7 Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën pëkatëse dhe kontratë).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhena të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

III.1.2. Referuar ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, neni 2, parashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.1.3. Në përputhje me nenin 24 pika 3 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në marrjen e vendimeve (Komisioni i Prokurimit Publik) mban parasysh, përveç parimeve të përgjithshme të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, edhe parimet e mëposhtme: paanshmërinë në shqyrtimin e ankesave, qëndrueshmërinë në vendimmarrje, ligjshmërinë, shpejtësinë dhe efikasitetin, aksesin, karakterin publik, si edhe parimin e kontradiktoritetit.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

III.1.5. Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin

përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.

III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarinimin, si më poshtë vijon:

a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;

b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;

ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;

dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;

e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;

f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;

gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.7. Në nenin 39, pika 4 dhe gërma “d” e pikës 6 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë

zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

6. *Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:*
 - a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
 - b) *që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë, kur një gjë e tillë është e detyrueshme nga legjislacioni përkatës; dhe/ose*
 - c) *një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose*
 - ç) *fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
 - d) *mjetet e pajisjet teknike, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.1.8. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, kapacitetet e konsideruara të nevojshme nga autoriteti kontraktor, për të zbatuar kontratën objekt-prokurimi. KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, si dhe që ka përgatitur ofertën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.9. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar në shtojcën 9, Kriteret e kualifikimit mbi kapacitetet teknike, kriterin 2.3.2, i modifikuar, mbi numrin e punonjësve, 5 të punësuar, i cili përmbushet me

formularin e vetëdeklarimit, shtojca 10, si edhe Kriteret 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6 në lidhje me punonjësit e kualifikuar në fushën e IT-së, cituar më sipër kriteret.

Operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK në përmbushje të këtyre kriterëve kualifikuese mbi kapacitetet teknike, ka ngarkuar në SPE, si pjesë të ofertës së tij, dokumentet si vijon:

Formulari përmbledhës i vetedeklarimit. Në brendi të të cilit konstatohet, se operatori ekonomik ka plotësuar formularin sipas shtojcës 10, në të gjitha seksionet në tërësi dhe në vecanti ka deklaruar në, Pjesa III Kriteret e Perzgjedhjes /Kualifimit, në B: Deklaratë Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme: 12 Punonjës.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik në përmbushje të kriterëve 2.3.4, 2.3.5. dhe 2.3.6 ka paraqitur dokumentet:

1. Z. O.B., me profesion, Inxhinier Softueri, Programues i punesuar ne rolin e Administratorit. Kontatë Pune date 19.07.2024 prane Shoqerise “Idealdevs Corporation” ShPK, Administrator i shoqerise.

2. Znj. O.M., me profesion “Inxhinier Softuere” e punesuar prane shoqerise sone. Certifikuar -Zhvillues Aplikacionesh NET, React JS nga Qendra Aliso Empoëer Yourself. Diplomë nga UT, Fakulteti i Ekonomisë, Bachelor në Informatikë ekonomike. Lëshuar më 2021. Diplomë Master i Shkencave në Siguria e Informacionit, lëshuar më 2023. Kontrate Pune. Datë 30.07.2024 me shoqerinë “Idealdevs Corporation” ShPK në pozicion pune Inxhinier Softuerik.

3. Z. Q.B., me profesion Programues, Diplomë e nivelit te pare, nga Universiteti “Eqerem Çabej”, Gjirokastrë, në Matematikë-Informatikë lëshuar më 2010. Diplomë Master Profesional Matematikë-Informatikë lëshuar më 2012. Kontratë pune, datë 26.09.2024 në pozicion Inxhinier Softuerik.

4. Z. E.S. Diplomë Bachelor në Inxhinieri Mekatronike lëshuar me 2021 nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Diplomë Master Profesional në Inxhinieri Mekatronike 2020-2021. nga Universiteti Politeknik i Tiranës. Kontratë Pune. Datë 07.01.2025 me shoqerinë “Idealdevs Corporation” SHPK në pozicion pune InxhinierMekatronik.

5. Z. Q.S., me profesion, Inxhinier Softueirk. I punesuar ne shoqerinë “Idealdevs Corporation” SHPK. Diplomë, lëshuar vertetim nga Universiteti European i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierise dhe Arkitektures , Studimet bachelor, diplomuar me 18.09.2024. Kontratë Pune date 27.01.2025, në pozicion Inxhinier Softuerik.

6. Zj. Z.B.,, Informatike ekonomike. Diplomë nga UT, Fakulteti i Ekonomisë, Studime te ciklit te pare, Informatike Ekonomike , leshuar vertetim me dt. 23.07.2025.

III.1.10. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa. Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit", të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.** 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. **Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterëve 2.3.2, 2.3.4, 2.3.5, dhe 2.3.6. operatori ekonomik "Idealdevs Corporation" SHPK, ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, shoqëruar gjithashtu me dokumentet e Kontratave të punës pranë shoqërisë si edhe Diploma të Arsimit të Lartë, për personelin e deklaruar.

Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor në fazën e vlerësimit procedural për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duhet t'i referohet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas rubrikave të aksesueshme elektronikisht nga autoriteti kontraktor dhe kërkesën për dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Akoma më tej Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti/enti kontraktor ai që duhet t'i kërkojë ofertuesit të kualifikuar, i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26 të VKM-së 285. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, për t'u siguruar nëse cilësia e shërbimit, punës apo mallit është e njëjtë me cilësinë e premtuar në momentin apo fazën e ofertimit.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm në fazën e vlerësimit të ofertave ashtu sikurse është përcaktuar në DST se *Përmbushja e këtij kriterit në fazën e ofertimit do të bëhet nëpërmjet dorëzimit të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së.*

Autoriteti kontraktor kërkon dokumentet provuese, operatorit ekonomik të renditur i pari, pasi ka përmbyllur fazën e vlerësimit të ofertave. Për më tepër, KPP vëren, se legjislacioni i prokurimit publik i njeh të drejtën autoritetit kontraktor, të verifikimit apo sqarimeve nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në lidhje me vërtetësinë dhe saktësinë e informacionit që përmbajnë dokumentet e paraqitura nga ata dhe më pas të marrë vendim lidhur me to.

Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë në lidhje me arsyet e skualifikimit për mospërmbushje të kriterëve kualifikuesë 2.3.4, 2.3.5. dhe 2.3.6.

Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit në këtë fazën e vlerësimit të ofertave, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK qëndron.

III.2. Në lidhje pretendimet e operatorit ekonomik mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së, me arsyen e skualifikimi për mospërmbushje të kriterit **2.3.7** Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën përkatëse dhe kontratë) me argumentet:

Nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” është vërejtur se OE nuk ka ngarkuar në sistemin elektronik asnjë dokument provues për këtë pikë, Komisioni mori në shqyrtim dokumentet si vijon:

III.2.1. Autoritet kontraktor ka publikuar në SPE, Dokumentet e tenderit, shtojcën 9,

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.7 Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën përkatëse dhe kontratë).

Argumentuar: *Certifikimi CISA vërteton se audituesi ka njohuri të thella dhe të gjerë në vlerësimin e rrezikut dhe kontrollit të teknologjisë së informacionit, duke siguruar që praktikën e auditimit janë në linjë me standardet ndërkombëtare. Ky ekspert është i pajisur për të identifikuar*

dobësitë në infrastrukturën e IT, të sugjerojë përmirësime dhe të monitorojë zbatimin e masave korrektive, duke ndihmuar OE të mbrojë pasuritë e saj digjitale, të përmbushë rregullat dhe të përmirësojë proceset e biznesit për të arritur objektivat strategjike.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit publik vëren, se Kriteret për Kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Nga ana tjetër operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës, depozituar në SPE, nga operatori ekonomik ankimues “Idealdevs Corporation” SHPK, Komisioni konstatoi se për përmbushjen e kriterit kualifikues 2.3.7, operatori ekonomik nuk ka paraqitur dokument, Mbi marrëdhëniet bashkëpunimi me një ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent...,

Gjithashtu referuar ankesës, mbi kundërshtimin të arsyeve të skualifikimit, Komisioni vëren se operatori ekonomik nuk ka argumentuar se si e ka përmbushur kriterin 2.3.7 të DST-së.

Komisioni thekson se Operatori ekonomik ofertues në një procedurë prokurimi është subjekti i parë i interesuar në përmbushjen e të gjitha kriterëve për kualifikim, përsa kohë i ka pranuar ato dhe ka ofertuar me dokumentacionin e ofertës.

Në rastin konkret, referuar dokumentacionit të dosjes administrative, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, nuk përmbush kriteret për kualifikim, e konkretisht kriterin e veçantë të kualifikimit 2.3.7. mbi kërkesën që: *“Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent (duke paraqitur certifikatën pëkatëse dhe kontratë).”*

Vendimi i KSHA-së, mbi mospranim të kësaj pike të ankesës, është i drejtë.

Pretendimet e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK nuk qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me procedurën e prokurimit, nga shqyrtimi i dosjes administrative mbi ecurinë e procedurës si edhe nga informacioni i AK-së, Komisioni nga verifikimet e kryera në SPE konstaton, se Autoriteti kontraktor ka vijuar procedurën e prokurimit me hapa të mëtejshëm edhe pas aplikimit nëpërmjet Sistemit Elektronik të Ankesave, të operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK me ankesën me numër ankimimi elektronik A/2025/6119, datë 24.11.2025 dhe me Nr. 3377/2025 Prot., datë 25.11.2025, e cila përcillet automatikisht nëpërmjet sistemit në të njëjtën kohë pranë Autoritetit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, gjithashtu publikuar në Sistemin Elektronik të Ankesave, Formulari për Publikim me datë 26.11.2025.

Nga Informacioni i përcjellë rezulton se Autoriteti Kontraktor ka konfirmuar faktin e vijimit të procedurës së prokurimit deri në përfundimin e lidhjes së kontratës me datë 04.12.2025, e më pas me arkivimin e dosjes, duke mos trajtuar ankesën, me justifikimin *se nuk ishte në dijeni të ankesës*, aplikuar në sistem, mbi kundështimin e vendimmarrjes së KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK. Komisioni gjykon se argumente të KSHA-së nuk justifikojnë veprimet e ndërmarra nga AK dhe as përjashtojnë nga përgjegjësitë autoritetin kontraktor. Përmes këtij veprimi, autoriteti kontraktor ka kryer shkelje procedurale të cilat vijnë në kundërshtim me legjislacionin mbi Prokurimin Publik.

Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara në një procedurë prokurimi. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Kodit të Procedurës Administrative). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga *lex specialis* janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtë me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor me veprimet dhe mosveprimet e tij ka kryer shkelje procedurale duke vijuar me hapa të mëtejshëm të procedurës së prokurimit pa shqyrtuar ankesën e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, aplikuar në Sistemin Elektronik të Ankesave njëkohësisht pranë AK-së dhe KPP-së duke konkluduar me lidhjen e kontratë së shërbimit e më pas me arkivimin e saj.

III.3.1. Në nenin 3 pika 1 të K.Pr.A, (Ligji 44/2015) *“Akti administrativ individual” është çdo shprehje e vullnetit nga organi publik, në ushtrimin e funksionit të tij publik, kundrejt një apo më shumë subjektsh të përcaktuara individualisht të së drejtës, i cili krijon, ndryshon ose shuan një marrëdhënie juridike konkrete.*

Neni 113 i Ligjit 44/2015 “Procedura dhe pasojat e anulimit dhe shfuqizimit” K.Pr.Administrative

1. *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj.*

III.3.2. Referuar nenit 119 *“Pavlefshmëria e kontratave”* të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar sipas të cilit parashikohet se: *1. Një kontratë do të konsiderohet absolutisht e pavlefshme në rastet e mëposhtme:*

b) kur nuk janë zbatuar parashikimet e këtij ligji në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar personat e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim;

d) Nëse një autoritet ose ent kontraktor ka nënshkruar një kontratë duke mos respektuar vendimin e dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Referuar nenit 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, sipas të cilit parashikohet se:

3. Pas lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit ose entit kontraktor është në kundërshtim me ndonjë nga dispozitat e këtij ligji, ka të drejtë: a) të deklarojë absolutisht të pavlefshme kontratën e nënshkruar, në përputhje me parashikimet e këtij ligji;

III.3.3 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se referuar parashikimeve ligjore të sipërcituara, si dhe verifikimeve të sistemit elektronik, një kontratë e cila është lidhur në kushtet e shkeljes së parashikimeve të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në lidhje me zbatimin e procedurave të ankimit, duke privuar operatorët e interesuar për të ushtruar të drejtën e tyre për ankim, si dhe duke mos zbatuar parashikimin ligjor duke mos trajtuar ankesën apo edhe në pritje të një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik mbi ankesën, autoriteti kontraktor rezulton në shkelje ligjore, pasi ka vijuar me hapa të mëtejshme procedurën e prokurimit dhe përfunduar atë me lidhje të kontratës edhe pse për procedurën objekt shqyrtimi është paraqitur nëpërmjet Sistemit Elektronk të Ankësave, ankesë nga operatori ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK, duke shmangur kështu trajtimin e ankesës së paraqitur nga ankuesi në shkelje kjo, me parashikimet ligjore dhe konkretisht në pika 1 dhe 4 e nenit 114 “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se: [...] Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

Për sa më sipër në kushtet kur autoriteti kontraktor ka vijuar me konfirmimin e lidhjes së kontratës me datë 04.12.2025, në shkelje të parashikimeve ligjore duke mohuar të drejtat e operatorëve ekonomikë, Komisioni gjykon, se kontrata është absolutisht e pavlefshme që në momentin e krijimit të saj, pavarësisht kushteve ose veprimeve që ndodhin më pas. Kjo do të thotë se kontrata nuk ka efekte juridike, as për palët që e kanë nënshkruar atë, pasi ka ardhur si një kontratë e lidhur në shkelje të ligjit procedural si dhe substancial dhe si e tillë nuk ka mundësi të krijojë detyrime apo të drejta për palët.

Për sa më sipër autoriteti kontraktor duhet të vlerësojë pavlefshmërinë absolute të kontratës së lidhur si dhe të anulojë procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi në kushtet e shkeljeve të ligjit procedural dhe substancial të sipërcituara në vendimi.

III. 3.4. Duke marrë shkas nga konstatimi i shkeljeve ligjore të kryera në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se autoriteti kontraktor ka vepruar në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik pasi ka mohuar të drejtat e operatorëve ekonomikë mbi ankesa në lidhje me vendimmarrjet e AK dhe shqyrtimin e tyre, ka vijuar me hapat

procedural duke mos pezulluar procedurën e prokurimit edhe pse ishte paraqitur ankesë nëpërmjet Sistemit, i cili i përcjell njëkohësisht ankesat tek Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Prokurimit Publik, lidhur me procedurën objekt ankimi.

Në referim të nenit 131 pika 1 dhe 2 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, parashikohet se: “1. Refuzimi i autoritetit ose entit kontraktor për të bashkëpunuar me Komisionin e Prokurimit Publik dhe Agjencinë e Prokurimit Publik ose moszbatimi brenda afatit i vendimeve të këtyre të fundit në mënyrë të pajustificuar ngarkon me përgjegjësi titullarin e autoritetit kontraktor dhe dënohet nga këto institucione me gjobë nga 50 000 (pesëdhjetë mijë) deri në 500 000 (pesëqind mijë) lekë.”

2. Masa e gjobës vendoset në raport me vlerën e përllogaritur të kontratës dhe sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”, si edhe referuar materialeve të administruara në fashikullin e shqyrtimit administrativ, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se me anë të veprimeve dhe mosveprimeve, autoriteti kontraktor ka cënuar të drejtat e operatorit ekonomik mbi shqyrtimin e ankesës, në kuptim të nenit 114 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në vijim të faktit se ka vijuar me hapa të mëtëjshëm, gjithashtu marrë në konsideratë faktin se titullari i autoritetit kontraktor nuk është përsëritës në shkeljen administrative pavaresisht natyrës dhe volumit të kontratave të procedurave të prokurimit, në mbështetje të nenit 24 dhe 131 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar:

Komisioni i Prokurimit Publik, vendos të marrë masën administrative gjobë, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë), lekë për z. Arif Tafani, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Belsh.

III.3.5 Komisioni i Prokurimit Publik në mbështetje të nenit 23 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar i propozon Agjencisë së Prokurimit Publik, nisjen e hetimit administrativ për zyrtarët përgjegjës për shkeljet e konstatuara.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 24 e në vijim të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Ligjit Nr. 10279 datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Idealdevs Corporation” SHPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-58131-08-14-2025, me objekt “Blerje programi për sistemin e taksave vendore të Bashkisë Belsh”, me fond limit në vlerën: 2,900,000 Lekë, pa TVSH, zhvilluar më datë 28.10.2025 nga autoriteti kontraktor Bashkia Belsh.
2. Të deklarojë pavlefshmërinë absolute të kontratës.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e prokurimit sipas konstatimeve të këtij vendimi.
4. Të marrë masën administrative gjobë në masën 50,000 (pesëdhjetë mijë) lekë për Z. Arif Tafani, Titullar i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Belsh.
5. Kjo gjobë përbën titull ekzekutiv.
6. T’i propozojë Agjencisë së Prokurimit Publik nisjen e hetimeve në bazë të konstatimeve të bëra në këtë vendim
7. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “Idealdevs Corporation” SHPK.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
9. Kundër vendimit për marrjen e masës administrative (gjobë) mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, në përputhje me Ligjin nr. 10279 datë 20.5.2009 “*Për kundërvajtjet administrative*”.
10. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar

Anila Malaj

Anëtar

Gjergj Mersini

Nënkryetar

Fiorent Zguro

